

KONTRATË
(SHITJE KUOTASH)

Në Ballsh, sot në datë. 03. 10. 2025 (dymijë e njëzet e pese), palët e poshtë shënuara të cilët konform Kodit Civil rane dakord me redaktimin e kontratës së shitblerjes së Kuotave të shoqërisë "EB-2000" shpk me nr Nipt-i: L87708801M, me adrese sipas ekstraktit të QKB, Fshati Rromes, Pasuria nr.92/91, Shtëpia 1 Kateshe, Zona Kadastrale 3191, Mallakaster, me këtë përmbajtje:

- **PALA SHITËSE** : Z. Engjëll Beqiraj shtetas shqiptar, i biri i Eqerem, lindur në Ballsh, i datelindjes 12.01.2000 me banim në Tiranë, i identifikuar me nr personal [redacted] madhor, me zotësi të plotë për të vepruar në cilësinë e oratakut të vetëm të shoqërisë "EB-2000", shoqëri e themeluar më 07.03.2018 dhe e regjistruar në Qendren Kombëtare të Biznesit me datë 07.03.2018 me nr Nipt-i : L87708801M, ketëj e tutje quajtur "Shitesi"
- **PALA BLERËSE** : Znj. Lumturi Beqiraj shtetase shqiptare, e bija e Petrit lindur në Cakran Ejer më 31.08.1980 dhe banues në Ballsh, e identifikuar me nr personal [redacted] madhore me zotësi të plotë për të vepruar, ketëj e tutje quajtur "Bleresi"

DUKE PATUR PARASYSH SE:

1. Bleresi është në procesin e blerjes së kuotës së shoqërisë me emërtim tregtar "EB-2000" shpk shoqëri e themeluar më 07.03.2018 dhe e regjistruar në Qendren Kombëtare të Biznesit me datë 07.03.2018 me nr Nipt-i : L87708801M me seli Fshati Rromes, Pasuria nr.92/91, Shtëpia 1 Kateshe, Zona Kadastrale 3191, Mallakaster, ketëj e tutje quajtur "Shoqëria".
2. Shitesi është zotëruar dhe posedues i padiskutueshëm i 100% kapitalit të shoqërisë (ketëj e tutje quajtur kuota).
3. Shoqëria ka një kapital prej njëqind mijë leke (100000) të ndarë në një kuotë të regjistruar dhe me vlerë nominale të kuotës prej 1(një) leke, e cila është nënshkruar dhe derdhur rregullisht dhe në mënyrë të vlefshme.
4. Me Vendimin e Asambesë së përgjithshme me Nr.2/10 Prot date 02.10.2025, është vendosur shitja e kuotave në masën 100% të tyre nga ana e Ortakut të Shoqërisë z. Engjëll Beqiraj, në masën 100%, dhe blerja e tyre nga znj. Lumturi Beqiraj në masën 100%.
5. Shitja në masën 100% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë "EB-2000" sjell humbjen e të drejtës së pronësive MBI KUOTAT E KAPITALIT THEMELTAR TE ORTAKUT TE SHOQERISE Z. Engjëll Beqiraj në masën 100%, si rrjedhojë e këtij transaksioni shitje kuotash të shprehur në Vendimin e Asambesë së përgjithshme me Nr.2/10 Prot date 02.10.2025.
6. Shitesi Engjëll Beqiraj është plotësisht dakord të shesë me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë perkatesisht në masën 100% të kuotave që ai zotëron në shoqërinë EB-2000. Kjo shitje kuotash, sipas kësaj kontrate do të bëhet në favor të blerësit znj. Lumturi Beqiraj në masën 100%.
7. Bleresi znj. Lumturi Beqiraj është dakord që të blejë me vullnetin e saj të lirë dhe të plotë masën prej 100% të kuotave të shoqërisë "EB-2000", të zotëruara nga shitesi në kapitalin themeltar të shoqërisë tregtare.

MENYRA E KALIMIT TE PRONESISE SE KUOTAVE .



- Me nënshkrimin e kësaj kontrate , shitesi , ortaku z. Engjell Beqiraj humbet pronësinë në masën 100% të kuotave të zotëruara prej tij në kapitalin themeltar të shoqërisë “EB-2000” duke mos patur në të ardhmen asnjë pretendim pronësor mbi kuotat e shitura të shoqërisë , ndërsa blerësi znj. Lumturi Beqiraj bëhet pronar në masën 100% të kuotave të shitura .
- Shoqëria tregtare “EB-2000” shpik për realizimin e kësaj operacioni shit-blerjeje kuotash , sipas kësaj kontrate do të ketë si ortak të saj me pjesëmarrje në kapitalin themeltar si më poshtë :

Znj . Lumturi Beqiraj zotëron 100% të kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë “EB-2000” të barabartë me 1 (një) kuotë.

ÇMIMI I SHITJES SE KUOTAVE

Si çmimi i kësaj transaksioni shit-blerjeje kuotash të shoqërisë “EB-2000” do të jetë shuma prej 100.000 leke (njëqind mijë) , çmimi I cili bazohet në vlerën nominale të kuotave sipas statutit të shoqërisë . E gjithë shuma , për të cilën palët bien dakord të jetë e drejtë , I paguhet shitesit nga blerësi .

DISPOZITA TE FUNDIT

Kjo kontratë u hartua në 4 (katër) kopje me fuqi të njëjta ligjore secila, ku nga një kopje të kontratës e marrin palët, një kopje depozitohet në Qendren Kombëtare të Biznesit , një kopje depozitohet në aktet e shoqërisë dhe një kopje pranë notarit . Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi, do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyn palët të lidhin këtë kontratë, në të kundërt do t’u referohet dispozitave të Kodit Civil, akteve ligjore e nënligjore që referohen në kontratë. Akti pasi redaktohet nga unë notari u lexohet palëve të cilët pasi e dëgjuan, kuptuan rëndësinë e kësaj akti e miratuan atë pasi e gjejnë të rregullt dhe në përputhje me vullnetin e tyre të lire e nënshkruajnë personalisht në prezencën time notarit.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITËSI
Z. ENGGJELL BEQIRAJ

BLERËSI
ZNJ. LUMTURI BEQIRAJ